



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:279363

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05477653

C.nr.1468/23

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B... me seli në Prishtinë, rruga ..., kundër të paditurit T.M nga Vushtrria rruga ..., me objekt kontesti Rimbursim i dëmit, me vlerë të kontestit 360.00 euro, jashtë seance me datë 20.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia për Rimbursimin e dëmit, e datës 14.12.2023, e paditëses B... me seli në Prishtinë, rruga ..., kundër të paditurit T.M nga Vushtrria rruga ..., për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

A r s y e t i m

Paditësja B... me seli në Prishtinë, rruga ..., me datë 14.12.2023, ka parashtruar padi për Rimbursimin e dëmit në shumën prej 360.00 euro, kundër të paditurit T.M nga Vushtrria rruga

Me datë 20.12.2023, gjykata ia ka dërguar paditëses Vërejtjen që në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore për padi në shumën prej 40 euro.

Paditësja me datë 26.12.2023, e ka pranuar Vërejtjen për pagesën e taksës për padi, por edhe pas kalimit të afatit, nuk e ka bërë pagesën e taksës.

Gjykata, në këtë rast nuk gjeti se ekzistojnë konditat për lirimin e paditëses nga pagesa e taksës gjyqësore, andaj konform nenit 253 par.5 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.1468/23, me datë 20.03.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.